

Nr. Prot. 041/B/25

VENDIM Nr. 2506

Për Miratimin e

“Rregullores mbi sigurinë dhe funksionimin e duhur të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 1), nenit 10 paragrafët 4) dhe 22), nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) dhe nenit 82 paragrafët 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (tutje referuar si – Ligji ose LKE), si dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP), Bordi i ARKEP në përbërje nga:

1. Z. Nazim Rahimi - kryetar,
2. Znj. Lule Ahmedi - anëtare,
3. Znj. Rrezarta Duraku Rizaj - anëtare,
4. Z. Arijan Qorolli – anëtar

në mbledhjen e rregullt të 53’të me radhë të mbajtur me datë 14 dhe 15 Maj 2025, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga DL dhe DKE për Rregulloren “**Mbi sigurinë dhe funksionimin e duhur të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike**” nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet “**Rregullorja për Mbi sigurinë dhe funksionimin e duhur të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike**”.
- II. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Ligji, respektivisht neni 10 paragrafët 4) dhe 22) (*Kompetencat e Autoritetit*) përkufizojnë kompetencat e Autoritetit për miratimin e legjislacionit sekondar dhe administrimit të konsultimeve për zbatimin e Ligjit si dhe rregulloret tjera të nxjerra nga Autoriteti.

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t’i publikojë ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Kjo rregullore përcakton të drejtat dhe detyrimet e operatorëve që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm për ofrimin e rrjetit dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, si dhe përcakton masat e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe funksionimin e duhur të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Kjo rregullore shfuqizon Rregulloren Nr.29 (Ref: Nr.Prot.046/B/16) mbi standardet teknike dhe organizative për sigurinë dhe integritetin e rrjetave dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Neni 106 i Ligjit e obligon Autoritetin që të miratojë legjislacionin sekondar në përputhje me kërkesat e Ligjit.

Pas shqyrtimit të komenteve të operatorëve të pranuar gjatë procesit të konsultimit publik, Autoriteti ka miratur Rregulloren së bashku me konkluzionet, përkatësisht qëndrimet e ARKEP ndaj komenteve të operatorëve dhe palëve të interesit. Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 27/05/2025

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Nazim Rahimi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- *Operatorëve (ndërmarrësve) të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;*
- *Departamenti i TIK, Ministrisë së Ekonomisë;*
- *Arkivës së Autoritetit.*